



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:141629
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05268194

Ac.nr.4963/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.M.L nga Peja, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “N.” SH.P.K - i autorizuari T.T nga Peja, kundër te paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari I.B, me bazë juridike, kompensim dëmi sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 15.000 euro, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/18, të datës 30.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit I.M.L nga Peja, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/18, i datës 30.04.2021, në pikën II (dy) të dispozitivit, në emër të dëmit jo material dhe në pikën I të dispozitivit për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë sa i përket dëmit material për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, si dhe shpenzimet e procedurës NDRYSHOHET, ashtu që gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” Prishtinë, që paditësit I.M.L nga Peja, t’ia paguajë shumat: për dëmin jo material; -në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 4,000.00 euro; -në emër të frikës shumë prej 3,000.00 euro, ndërsa në emër të dëmit material – për ushqim të përforcuar shumë prej 280.00 euro ndërsa – në emër të kujdesit të personit të tretë shumë prej 280.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1158 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, ndërsa REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit I.M.L nga Peja,

përtej shumave të aprovuara sikurse në këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit për këto format e dëmit.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/18, i datës 30.04.2021, NDRYSHOHET ashtu që gjykohet: DETYROHET e paditura që pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë së paditësit për kompensimin e të gjitha formave të dëmit, t’ia paguajë me kamatë ligjore 8%, nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë me datë 30.04.2021 e deri në pagesën definitive, ndërsa refuzohet kërkesa për kamatë në lartësi prej 12 %, e pathemeltë.

III. REFUZOHEN pjesërisht të pathemelta ankesa e paditësit I.M.L nga Peja dhe e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” Prishtinë, ndërsa pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/18, i datës 30.04.2021, në pjesën e kërkesëpadsisë që i referohet dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumë prej 3000 euro, si dhe shpenzimet e mjekimit në shumë prej 15 euro, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.169/18, të datës 30.04.2021, ka vendosur si në vijim:

“I. PJESËRISHT APROVOHET - kërkesëpadsia e paditësit I.M.L nga Peja si e bazuar.

II. DETYROHET - e paditura Kompania e Sigurimeve “E.”, në Prishtinë që në emër të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt.03.01.2017 sipas bazës së autopërgjegjësive ti paguaj paditësit shumat si në vijim:

*-Në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumë prej 2000 euro,
- Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 3000 euro,
-Frikën e përjetuar në shumë prej 1000 euro, -Shpenzimet e mjekimit në shumë prej 15 euro,
-Si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 700 euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, me kamatë prej 12% nga dita e vendosjes 30.04.2021 e deri në pagesën definitive.*

I. REFUZOHET - pjesa e kërkesëpadsisë të paditësit I.L dhe atë:

*-Në tërësi shumë prej 1.000 euro në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj,
-Shumë prej 500 euro në emër të ushqimit të përforcuar
-Në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumë prej 3000 euro,
-Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 4000 euro,
-Frikën e përjetuar në shumë prej 2000 euro,*

-Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë se paditësit sa i përket shpenzimeve të procedurës mbi shumën e gjykuar e në lartësi prej 666 euro e të gjitha këto si të pa bazuara.”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i palës paditëse për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën sipas precizimit të kërkesëpadisë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i palës të paditur dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ta aprovojë si të bazuar ankesën, aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë sipas pretendimeve të paditurës ose ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit dhe ankesa e të paditurës janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, 22.02.2018 kundër te paditurës K.S “E.” në Prishtinë për kompensim të dëmit sipas autopërgjegjësisë si pasojë e aksidentit të dt. 03.01.2017, të cilën e ka precizuar sipas parashtrësës së datës 17.03.2021. Në padi dhe precizimin e saj, kanë theksuar se, me datë 03.01.2017, rreth orës 16:30, është shkaktuar aksident trafiku, në të cilin ishin të përfshirë vetura e markës “Mercedes” me tabela të regjistrimit 03-881-EN, të cilin ditën kritike e drejtonte L.B.L, nga Peja, rruga “N.”, nr. .. si dhe këmbësori I.M.L po ashtu nga Peja. Si pasojë e aksidentit të shkaktuar paditësi ka pësuar lëndime trupore. Andaj me qëllim të realizimit të zhdëmtimit sipas aksidentit të komunikacionit, paditësi i ka propozuar gjykatës që të aprovon kërkesëpadinë e paditësit duke ia njohur kompensimin e dëmit material dje jo material.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesëpadisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.169/18, i datës 28.04.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë por vetëm lartësia e saj. Bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata e vërtetoi në bazë të ekspertizës së komunikacionit, të datës 02.03.2017, nga eksperti S.B, i cili në mendimin dhe konstatimin e dhënë me shkrim ka konstatuar se shkaktar i aksidentit të datës 03.01.2017 është i siguruari i të paditurës.

Për të vërtetuar lartësinë e kompensimit të dëmit gjykata e shkallës së parë, ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë – traumatologjisë dhe psikiarisë. Ekspertët mjekësor Dr. N.M, ortoped – traumatolog dhe Dr. M.H, psikiatër, në seancën e darës 17.03.2021, pas ekzaminimit të palës paditëse dhe shikimit të shkresave tjera të lëndës kanë dhënë mendimin dhe konstatimin se, paditësi ka pësuar thyerje te ramosuperipo osipuglis natyra e lëndimit është e rëndë me përqindje invaliditeti prej 5% . Ka përjetuar dhimbje të intensitetit tejet të lartë për 3 minuta, dhimbje të intensitetit teje të lartë 3 minuta, dhimbje të intensitetit te lartë për 4 orë, dhimbje të intensitetit të mesëm 4 javë, dhimbje te intensitetit të ulet me kohë zgjatje prej 8 jave. Shëmtim nuk ka pasur, ndihma e personi te huaj ka qenë e nevojshme në kohë zgjatje prej 4 jave. Ushqimi i përforcuar ishte e nevojshme me kohe zgjatje prej 4 javësh. Terapi fizikale qe e nevojshme 20 ditë në vitin e parë. Me tutje ka shtuar se, paditësi ka përjetuar frikë primare te intensitetit te larë ne kohëzgjatje prej disa sekondave kjo periudhe është e përcjellur me shtangim afektiv, frikë sekondare me intensitet të lart ka pasur ne periudhën kohore gjeri ne 3 orë te manifestuar me mundim te rrahura te shpejtuara të zemrës frymëmarrje te vështirësuar dhe ankesa te tjera trupore, frikë sekondare me intensitet të mesëm ka pasur ne periudhën kohore gjeri ne 8 jave te manifestuar me një çrregullim afektiv afat gjatë si pasojë e aksidentit si indisponim pengesa të herëpashershme në gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike, shkallë më të ulët të tolerancës frustative dhe ankesa te tjera trupore, frikë sekondare me intensitet te ulet ka pasur ne përudhen kohore gjeri në 6 muaj e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dal ne komunikacion apo ngjarje qe ja kujtojnë aksidentin.

Gjykata eksperteve mjekësor të lartpërmendur ju ka falur besimin e plotë, sepse ekspertet kanë dhënë mendimin e tyre në mënyrë profesionale dhe arsye të mjaftueshme për të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Lidhur me bazën dhe lartësinë për kompensimin e dëmit gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e 183 të LMD-së.

Kamatën e ka gjykuar në pajtim me nenin Vendimi mbi kamatën është i bazuar në dispozitat, e nenit 382 par 1 dhe 2 i LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka bazuar në dispozitat e nenit 452 par. 2 i LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, përveç në pjesën ku aktgjykimi është dashur të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182

al.2, pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktgjykimit është i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetimin të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk kemi vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se me datë 03.01.2017, rreth orës 16:30, është shkaktuar aksident trafiku, ku shkaktar i aksidentit ishte i siguruari i të paditurës. Si pasojë e aksidentit të shkaktuar paditësi i cili ishte këmbësor ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses, gjen mbështetje në nenin 136, 140, 159 paragrafi 1, dhe neni 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Me dispozitën e nenit 183 të LMD-së parashihet që: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.”*

Gjykata e Apelit i pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit, sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë për ndihmën dhe kujdesin e huaj, ushqimin e përforcuar, e duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në kuptim të nenit 195 par.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka aprovuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit që i referohet dëmit material dhe për ndihmën dhe kujdesin e huaj ia ka gjykuar shumën 280 Euro, për ushqim të përforcuar ia ka gjykuar shumën prej 280 Euro, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, sipas të cilave paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 4 javë dhe për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 4 javë, duke vlerësuar se kompensimi për këto kategori të dëmit është pranuar në praktikën gjyqësore, e që zakonisht anëtarët e familjes kujdesen dhe i japin ndihmë, në këtë rast paditësit,

si dhe ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm, i pasur me vitamina dhe minerale për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të paditësit, si rezultat i lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 03.01.2017. Kjo gjykatë vlerëson se shumatat e gjykuara për dëmin material ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqim të përforcuar janë shuma proporcionale me dëmin e shkaktuar, duke u bazuar në ekspertizën mjekësore dhe kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të paditësit sa i përket shumave të gjykuara, e duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit që i referohet dëmit jomaterial për dhimbje fizike dhe për frikën e përjetuar, ashtu që gjykata e shkallës së lartë me aplikimin e praktikës gjyqësore ka arritur në përfundim se shpërblimi për këtë kategori të dëmit nuk është në proporcion me të mirën e shkelur, andaj kjo gjykatë ia ka gjykuar për frikën e përjetuar shumën 4000 Euro, ndërsa për frikën e përjetuar ia ka njohur shumën prej 3000 euro, duke konsideruar se kjo shumë është në proporcion me të mirën e shkelur dhe që iu shkon përshtati synimeve për të cilat ka për qëllim kompensimi, e që është një satisfakcion për palën e dëmtuar që sado pak ti zbusë pasojat e dëmtimeve, ndërsa pjesa tjetër për këtë kategori të dëmit përtej shumës së gjykuar është refuzuar si e pabazuar, duke arsyetuar se lartësia e kërkesës më tepër se shumata e gjykuar nuk iu shkon përshtati synimeve për të cilat ka për qëllim kompensimi. Andaj gjykata e shkallës së lartë është bazuar në kuptimin e dispozitës së nenit 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ku parashihet se : *1. Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë do të gjykojë kompensimin e dëmit material si dhe mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror”.*

Gjykata e Apelit, duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në kuptim të nenit 195 par.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar kamatën ligjore nga 12% në 8 %, duke vlerësuar se, gjykata e shkallës së parë në rastin konkret është dashur të zbatojë nenin 382.2 i LMD-së. Për këtë arsye ka vendosur që të ndryshojë kamatën ligjore, duke vendosur që për shumatat e aprovuara kamata ligjore të jetë 8% dhe e cila do të fillojë të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me datë 30.04.2021 e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit i pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditëses, sa i përket shpenzimeve të procedurës, për shkak se kjo Gjykatë gjen se, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore palës paditëse ia ka

njohur shpenzimet e procedurës në lartësi prej 700 euro, pa dhënë arsye dhe pa specifikuar se si ka ardhur deri të një vlerësim i tillë.

Më dispozitën e nenit 449 të LPK shprehimisht parashihet „ *Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur më procesin gjyqësor, ku shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji i jep të drejtën e shpërblimit* “Ndërsa më dispozitën e nenit 452.1 të LPK shprehimisht parashihet se „ *Pala e cila ka humbur procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore* “.

Me dispozitën e nenit 463.1 të LPK-së parashihet që: “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.*”, paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: “*Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, Nëse nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.*” Ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen parasheh që: “*Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e Nëse është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtrrojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendos.*” Pala paditëse përmes të autorizuarit të saj, me parashtrësën i ka kërkuar shpenzimet e procedurës të specifikuara.

Andaj, në një rrethanë të tillë Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit duhet ndryshuar dhe paditësja si palë gjyq fituese duhet njohur shpenzimet e procedurës kontestimore, në pagesën e të cilave obligohet e paditura e cila i ka dhënë shkas inicimit të procedurës dhe ka humbur kontestin në këtë çështje kontestimore, ku shpenzimet e njohura paditëses kanë mbështetje në dispozitën e nenit 449, 452, 453 dhe 463 të LPK. Këto shpenzime të njohura i referohen, për përpilimin e padisë shumë prej 208 euro, për tri seanca të mbajtura shumë prej nga 270 euro, gjithsejtë shumë prej 810 euro, për ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë – traumatologjisë dhe psikiatrisë shumë prej nga 70 euro, gjithsejtë shumë prej 140 euro, pra GJITHSEJTË shuma prej 1158 euro, ku shumat e gjykuara të paditësit kanë mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe janë në përputhje të plotë me nenin 449.1 dhe 452.1 të LPK-së. lartësia e shpenzimeve është në përputhje me shpenzimet e krijuara dhe tarifat përkatëse për këto shpenzime, ndërsa përtej shumës së gjykuar gjykata e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditëses respektivisht shumë prej 208 euro.

Gjykata e Apelit, i ka refuzuar pjesërisht pretendimet ankimore të përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurës, dhe në pjesët tjera e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të gjitha format e dëmit, duke konsideruar se shuma e gjykuar është në proporcion me të mirën e shkelur, për shpenzimet e shërimit, të cilat shpenzime me prova-fatura janë vërtetuar, e që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit ka vërejtur se, në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit është shënuar numri I (një), mirëpo kjo gjykatë ka vlerësuar se mund të jetë ndonjë gabim teknik që nuk mund të merret si arsye për prishjen e aktgjykimit, sepse në

arsyetim të aktgjyimit, gjykata e shkallës së parë dhënë arsye për këtë pikë për refuzimin pjesës së kërkesëpadisë së paditësit, andaj edhe nuk kishte ndonjë relevancë që kjo gjykatë të vendos ndryshe nga ajo siç është vendosur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi të gjitha pretendimet ankimore të palëve ankuese, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4963/2021 me datë 26.01.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.